



*Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!*

**Në këtë buletin do të gjeni:**



***Dialogu i nivelit të lartë për transparencën e klimës COP 29***




***Trajnimi mbi Monitorimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm***



***Takimi rajonal "Drejt një regjistri të zonave të kontaminuara"***



***Aplikimet dhe monitorimi i lejeve mjedisore***



***Vizita studimore në Agjencinë Evropiane të Mjedisit***



***Mostrimi i Shkarkimeve në Mjedis***



***Bashkëpunimi me organizatën rinore "Përtej Barrierave"***



***Takime në lidhje me kimikatet***




***Bashkëpunimi AKM- IMPEL***

## Dialogu i nivelit të lartë për transparencën e klimës COP 29

Në COP 21 në 2015, Palët miratuan Marrëveshjen e Parisit dhe përmes saj krijuan një Kornizë të Përmirësuar të Transparencës (ETF) e ideuar për të ndertuar besim dhe sigurinë se të gjitha vendet po kontribuojnë në përpjekjet globale për ndryshimet e klimes. Zbatimi i Marrëveshjes së Parisit dhe detajet e saj operacionale, duke përfshirë ETF-në dhe modalitetet, procedurat dhe udhëzimet e tij (MPG) që janë të zbatueshme për të gjitha vendet kërkojnë mirëkuptim dhe kapacitete të zgjeruara teknike. Duke pranuar që Palët kanë pika fillestare të ndryshme, ETF dhe MPG-të e tij ofrojnë fleksibilitet për ato Palë të vendeve në zhvillim që kanë nevojë për të në dritën e kapaciteteve të tyre për disa nga dispozitat specifike të MPG-ve.

Në këtë kontekst, të gjitha palët në Marrëveshjen e Parisit u kërkohet të dorëzojnë Raportet e tyre të parë dyvjeçare të Transparencës (BTR), në përputhje me MPG-të, jo më së vonë se 31 dhjetor 2024 dhe çdo dy vjet që nga ai moment. Me synimin për të kontribuar në përpjekjet e vazhdueshme për të arritur pjesëmarrjen universale në ETF, Presidenca COP29, me mbështetjen e Sekretariatit të Konventes Kuader të ndryshimeve Klimatike (UNFCCC), organizoi një Dialog të Nivelit të Lartë më 3 shtator për të vazhduar nxitjen për rritjen e veprimtimit të transparencës përpara COP29.



Shqipëria si palë e Marrëveshjes së Parisit COP21 në 2015, ishte pjesëmarrëse në këtë dialog të organizuar nga Presidenca e COP 29 në 3, Shtator 2024 në Baku, Azerbaixhan, e përfaqësuar nga pika fokale për raportimin e inventarit të gazeve serë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në datat 4 dhe 5 shtator u organizua trajnimi mbi mënyrën e raportimit të Common Reporting Tables (CRT).

Dialogu u fokusua në disa çështje që lidhen me zbatimin e marrëveshjes së Parisit duke përfshirë Kornizën e Përmirësuar të Transparencës (ETF) dhe modalitetet e tij, procedura dhe udhëzues që zbatohen nga vendet dhe konkretisht:

- ✚ synon të krijojë besim midis palëve dhe të rrisë ndërgjegjësimin politik për rëndësinë e pjesëmarrjes universale në ETF
- ✚ të nxisë bashkëpunimin midis palëve të interesuara për të mbështetur zbatimin e suksesshëm të ETF dhe dorëzimin në kohë të BTR-ve
- ✚ synon të identifikojë dhe adresojë boshllëqet e kapaciteteve dhe nevojat teknike të palëve, duke siguruar që të gjitha vendet të jenë të përgatitura mirë për të përmbushur detyrimet e tyre të transparencës



Për më tepër, qëllimi i këtij dialogu ishte që të shërbejë si një mundësi për të përforcuar përkushtimin politik për transparencë dhe llogaridhënie në veprimet klimatike, ku do të nxjerrë në pah rolin kritik të transparencës në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe në rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke mbështetur përfundimisht përpjekjen globale për të luftuar ndryshimin e klimesë.

## Trajnimi mbi Monitorimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm

Në datat 11-13 shtator 2024 u mbajt trajnimi me titull "Monitorimi i Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm, avancimet e menaxhimit të të dhënave dhe interpretimi i të dhënave", organizuar nga Qendra Rajonale e Konventës së Stokholmit RECETOX, Universiteti Masaryk në kuadër të projektit Global NIP Update (GEFID 10785), të zbatuar në Evropën Qendrore dhe Lindore ku morrën pjesë vende si (Shqipëria, Armenia, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Kazakistani, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut). Nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit morrën pjesë 4 përfaqësues por gjithashtu pjesëmarrës ishin dhe përfaqësues nga institucionet e tjera si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve etj.



Ky trajnim kishte në fokus forcimin e kapaciteteve të ekspertëve dhe për të prezantuar gjeneratat ekzistuese, por edhe të reja (kërkuesit e rinj ose specialistë) në temën e monitorimit të NOQ-ve, menaxhimit dhe interpretimit të të dhënave dhe për t'u ofruar atyre një qasje në mjetet moderne të disponueshme (globalisht ose në BE) në menaxhimin e të dhënave dhe interpretimin e tyre.

Objektivat e këtij trajnimi u përqëndruan në:

- ✚ Sigurimin e informacionit mbi masat për monitorimin e NOQ-ve sipas Konventës së Stokholmit
- ✚ Shkëmbimin e njohurive mbi marrëveshjet dhe sfidat e monitorimit të NOQ-ve në vende të veçanta

- Praktikimin e marrjes e mostrave pasive të ajrit, ujit dhe matricave të tjera mjedisore dhe njerëzore Rrjetet ekzistuese të monitorimit dhe sinergjitë e mundshme ndërmjet tyre
- Vizitë në laboratorët dhe objektin e biobankës të RECETOX
- Bashkëpunimi në monitorimin ndërmjet sektorëve të mjedisit dhe shëndetësisë për qëllime të vlerësimit të rrezikut shëndetësor dhe mjedisor.
- Lidhja e raportimit kombëtar sipas Konventës së Stokholmit, aktiviteteve kërkimore dhe infrastrukturave të disponueshme për mbështetjen e vendeve të projektit - për t'u bashkuar ose për t'u ndjekur.



### Takimi rajonal “Drejt një regjistri të zonave të kontaminuara”

EU4Green organizoi në 7-8 Tetor 2024, Shkup, Maqedoni e Veriut takimin rajonal me vendet e Ballkanit Perëndimor “Drejt një regjistri të zonave të kontaminuara”. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Objektivi i takimit të dytë rajonal ishte të diskutonte praktikatat më të mira për identifikimin, menaxhimin dhe krijimin e regjistrave gjithëpërfshirës kombëtarë të vendeve të kontaminuara. Ndotja e tokës në rajon kufizon mundësitë për zhvillim të ardhshëm dhe paraqitet kërcënime për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Krijimi i regjistrave efektivë të zonave të kontaminuara është një hap i parë kritik në adresimin e çështjes së menaxhimit të tyre.



Gjatë takimit u prezantua “Udhëzues për identifikimin e aktiviteteve kryesore ndotëse dhe zonave të kontaminuara në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor”. Udhëzuesi ofron rekomandime për hapat e parë në menaxhimin e vendeve të kontaminuara - nga faza e parë me identifikimin e aktiviteteve kryesore ndotëse të tokës që gjenden zakonisht në ekonominë specifike dhe një inventar paraprak të vendeve të kontaminuara lehtësisht të disponueshme. Një hap i dytë mund të përfshijë qasjen sistematike për një regjistër si dhe mekanizmat e financimit.

Gjithashtu u paraqitën eksperiencat e vendeve të ndryshme në lidhje me zhvillimin e sistemit kombëtar dhe rajonal për monitorimin dhe menaxhimin e vendeve të kontaminuara, të cilat mund të shërbejnë si model për vendet e BB6 si dhe një studim mbi dekontaminimin e tokës, duke u fokusuar veçanërisht në krijimin e një kadastrë të zonave potencialisht të kontaminuara. U dhanë shembuj të ndotësve të rinj (farmaceutike) të shfaqur që lidhen me vendet e kontaminuara dhe nevojën për t'i përfshirë ato në strategjinë kombëtare të menaxhimit të tokës.

Përfaqësues i Agjencisë Europiane të Mjedisit prezantoi projektin IPA III “Vrojtimi kombëtar i vendeve potencialisht të ndotura në WB6” dhe roli i tij në kryerjen e vëzhgimit të vendeve potencialisht të ndotura në të gjithë rajonin WB6.

Ai nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe mbledhjen e të dhënave për të rritur përpjekjet për mbrojtjen e tokës.

Në përfundim nga organizatorët (Agjencia Austriake e Mjedisit) u paraqit një pasqyrë e hapave të mundshëm për menaxhimin e vendeve të kontaminuara – krijimi i një regjistri gjithëpërfshirës për vende të kontaminuara.

Do të përpunohet një dokument udhëzues me qëllim që të japë një pasqyrë të qasjeve për regjistrat sistematikë dhe ndoshta vlerësimin paraprak.

Pjesëmarrësit vizituan vendin e industrisë së kimikateve organoklorine në Shkup, i cili është kontaminuar nga lindani (HCH).



### Aplikimet dhe monitorimi i lejeve mjedisore

Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë periudhës Shtator-Dhjetor ka shqyrtuar 94 kërkesa për Dëgjese me Publikun nga të cilat

- 13 subjekte kanë bërë kërkesë për VNM Paraprake
- 6 subjekte kanë bërë kërkesë për Deklaratë Mjedisore
- 75 subjekte kanë aplikuar për Leje Mjedisore nga të cilat 3 janë anuluar

Gjithashtu është kryer kontrolli dhe shqyrtimi i raporteve të vetmonitorimit të dorëzuara nga subjektet mbi zbatimin e kushteve të lejeve/VNM/Deklaratave. Janë informuar me shkresë përkatëse 300 subjekte që dorëzojnë raportet periodike të vetmonitorimeve me mangësi dhe jo sipas kushteve të Lejes/VNM/Deklaratës.

Është kryer evidentimi i 1000 subjekteve që janë pajisur me Leje Mjedisore/ VNM/ Deklaratë dhe nuk kanë dorëzuar raportet periodike të vetëmonitorimeve, brenda afateve për vitet 2023 dhe 2024, si dhe nxjerrja e shkresave lajmëuese drejtuar këtyre subjekteve, duke vënë në dijeni më pas edhe strukturat inspektuese.

## Vizita studimore në Agjencinë Evropiane të Mjedisit

Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit, organizoi së fundmi një vizitë studimore në Agjencinë Evropiane të Mjedisit (AEM) në Kopenhagen më 26-27 nëntor, duke mbledhur së bashku përfaqësues të ministrive të transportit, autoriteteve rrugore dhe agjencive mjedisore nga Ballkani Perëndimor, Gjeorgjia, Moldavia, dhe Ukrainës. Në këtë vizitë studimore ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit e Shqipërisë.

Vizita studimore rriti të kuptuarit e projekteve rrugore të ndjeshme ndaj mjedisit dhe forcoi bashkëpunimin që synon arritjen e objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Lëvizshmërisë së zgjuar dhe të Qëndrueshme. Vizita u dha pjesëmarrësve njohuri të vlefshme për rolin e AEM në integrimin e konsideratave mjedisore në sistemet e transportit dhe energjisë. Ai shënoi gjithashtu hapin e parë drejt një bashkëpunimi më të ngushtë midis AEM dhe Ballkanit Perëndimor, duke u fokusuar në adoptimin e standardeve të BE-së dhe praktikave të qëndrueshme në projektet e infrastrukturës.



Në ditën e dytë, pjesëmarrësit ndoqën një sesion trajnimi të udhëhequr nga **JASPERS, programi këshillues i Bankës Evropiane të Investimeve**. Sesioni u fokusua në procedurat, rregullat dhe standardet e BE-së për Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor dhe Social. Pjesëmarrësit eksploruan boshllëqet midis kornizave të BE-së dhe rajonale dhe mësuuan nga studimet e rasteve që theksuan sfidat praktike dhe zgjidhjet në vlerësimet mjedisore.

Ky sesion ofroi gjithashtu një platformë për shkëmbimin e përvojave, sfidave dhe mësimet të nxjerra nga zbatimi i projekteve rrugore me fokus në qëndrueshmërinë mjedisore. Vizita studimore është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Komunitetit të Transportit për të mbështetur Ballkanin Perëndimor në përafrimin me standardet e BE-së në transportin rrugor. Ai gjithashtu kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit për ndikimin mjedisor të projekteve të infrastrukturës dhe inkurajimin e praktikave të qëndrueshme ndërgjegjësimit për ndikimin mjedisor të projekteve të infrastrukturës dhe inkurajimin e praktikave të qëndrueshme.



## Mostrimi i shkarkimeve në mjedis

Një nga fushat e veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është marrja e mostrave në shkarkime ujore dhe analizimi për parametrat fiziko-kimike me qëllim vlerësimin e cilësisë së tyre.

Sektori i Mostrimit dhe i Shkarkimeve në Mjedis gjatë periudhës Shtator – Dhjetor 2024, ka kryer rreth 30 mostrime në Laguna, Liqene, Dete dhe në shkarkime të ndryshme të pakontrolluara në ujërat pritëse.



Këto mostrime kryhen për të përcaktuar nivelin e ndotjes në këto ujëra, në mënyrë që të krijohen dhe hidhen ide të qarta, për zvogëlimin dhe parandalimin e ndotjes në mjedis.

## Bashkëpunimi me organizatën rinore “Përtej Barrierave”



Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me organizatën rinore shqiptare “Përtej Barrierave” e cila është e angazhuar në fuqizimin e të rinjve dhe promovimin e përfshirjes sociale, në kuadër të projektit ndërkombëtar “Youth Care” të financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit Erasmus+ KA2, organizuan më 11 Dhjetor 2024 një vizitë studimore me 30 profesionistë dhe të rinj nga Ballkani dhe Evropa.



Pjesëmarrësit ishin nga Shqipëria, Mali i zi, Greqia dhe Italia ku u diskutua mbi nxitjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit në mbrojtjen e mjedisit.

### Takime në lidhje me kimikatet

Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM-së) i emëruar si Pikë Fokale e Konventës së Roterdamit gjatë kësaj periudhe, Shtator- Dhjetor ka marrë pjesë në disa takime online për Procedurën PIC dhe në kuader të saj gjatë kësaj periudhe janë marrë 32 Njoftime Eksporti nga ECHA dhe dy kërkesa për pëlqim të qartë për eksport për dy kimikate nga Republika Serbe .Për të forcuar legjislacionin kombëtar të kimikateve në fuqi, për çdo njoftim të marrë, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar në bashkëpunim me institucionet që merr pjesë në autorizimin e kimikateve në Shqipëri, ka kryer një proces verifikimi, ka përgatitur formatet për dhënien e përgjigjeve në lidhje me procedurat e PIC, bazuar në zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 21.9.2016, për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.

Në datat 10-12 Dhjetor u mbajt takimi i rradhes organizuar nga Komiteti për Levizjen e Mallrave të Rrezikshme, TDG, i cili u ndoq online nga përfaqësues të Sektorit të Menaxhimit të Kimikateve. Përfaqësuesit e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Hekurudhat (ERA) prezantuan procedurat për sistemet e menaxhimit të sigurisë, rolin e këshilltarëve për sigurinë e mallrave të rrezikshme dhe procedurat e autorizimit dhe mirëmbajtjes.

Gjithashtu në datë 18.12.2024 u mbajt takimi në kuadër të REACH dhe CLP, ku morën pjesë online përfaqësues nga Sektori i Menaxhimit të Kimikateve.



### Bashkëpunimi AKM- IMPEL

Në konferencën IMPEL “Zogjtë në Aerodrome” i zhvilluar në Paris Orly, 20-22 Nëntor 2024, morën pjesë përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) si dhe ekspertë mjedisorë të huaj, menaxherë aeroportesh, përfaqësues të BE-së, dhe organizata joqeveritare që punojnë për mbrojtjen e shpendëve dhe habitateve. U diskutua mbi praktikën më të mira për menaxhimin e konflikteve mes shpendëve dhe aerodromeve, mbrojtjen e habitateve dhe implementimin e Direktivës për Shpendët dhe Habitatet në aerodrome (aerporte) dhe zonat përreth tyre.

Qëllimi i konferencës :

#### 1.Mbrojtja e shpendëve

Sigurimi që habitatet dhe popullatat e shpendëve nuk dëmtohen nga zhvillimi dhe funksionimi i aerodromeve.

#### 2. Menaxhimi i konfliktit mes aviacionit dhe shpendëve

Zvogëlimi i rrezikut nga përplasjet e avionëve me shpendë (bird strikes) duke zhvilluar metoda ekologjike dhe teknike për të shmangur këto incidente.Vendosja e strategjive për të mbajtur shpendët larg pistave të aerodromeve pa dëmtuar biodiversitetin.

### 3. Harmonizimi i standardeve mjedisore në BE

Sigurimi që të gjitha shtetet anëtare zbatojnë Direktivën për Shpendët dhe Habitatet në mënyrë të unifikuar.Shkëmbimi i praktikave më të mira për menaxhimin e habitateve në zonat pranë aeroporteve.

### 4. Ruajtja e habitateve natyrore në zonat urbane

Reduktimi i ndikimit të zhvillimit të aeroporteve mbi zonat e mbrojtura dhe habitateve natyrore që strehojnë shpendë migratorë dhe të përhershëm. Krijimi i korridoreve ekologjike për shpendët, duke lidhur habitate të ndryshme dhe duke lehtësuar migrimin e tyre të sigurt.

### 5. Zhvillimi i teknologjive të reja për mbrojtjen e mjedisit

Përdorimi i radarëve për monitorimin e lëvizjes së shpendëve dhe përcaktimin e zonave të rrezikut pranë aeroporteve. Zhvillimi i sistemeve të largimit të shpendëve që janë ekologjike dhe të padëmshëm, si pajisjet akustike ose lazerat.

### 6. Edukimi dhe ndërgjegjësimi

Trajnimi i stafit të aeroporteve dhe komuniteteve lokale për të mbrojtur biodiversitetin. Fushata ndërgjegjësimi për të promovuar rëndësinë e mbrojtjes së shpendëve dhe habitateve të tyre.

### 7. Monitorimi dhe raportimi i ndikimeve

Krijimi i databazave që regjistrojnë incidentet me shpendë në aeroporte, duke analizuar shkaqet dhe ndikimet për të përmirësuar politikën. Matja e ndikimit të aeroporteve në biodiversitet dhe gjetja e zgjidhjeve për të minimizuar këto ndikime.

### 8. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Bashkëpunimi mes vendeve të BE-së për zbatimin e masave të përbashkëta në menaxhimin e zonave pranë aeroporteve. Angazhimi i organizatave ndërkombëtare që merren me ruajtjen e shpendëve për të ndihmuar në ndërtimin e strategjive më efektive.

Gjithashtu në kuadër të forcimit të kapaciteteve, përfaqësues të AKM-së kanë marrë pjesë në takime të ndryshme organizuar nga IMPEL ku përmendim:

- ✦ *Industry & Air meeting– Schiedam (IED implementation WG), The Netherlands 15-17 October 2024*
- ✦ *Workshop & Joint Inspection for EU Action Plan Against Wildlife Trafficking IMPEL project, São Miguel, Azores PT, 15 & 16 November 2024*
- ✦ *National Peer Review Initiatives (NPRI) Seminar, Athens, 3-4 December 2024*
- ✦ *IMPEL Ukraine Support Conference & IRI Open Workshop, Prague, 10-11 December 2024*
- ✦ *Venice Water & Land Conference 29-30 October*